



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 03.11.2016 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. ZYRTAR PËR INFORMIM DHE MONITORIM TË MEDIAVE

Drejtoria: ZYRA E KRYETARIT

Njësia/ sektori: PËR INFORMIM

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: koeficienti aktual- 7

Numri i referencës së vendit të punës: 01Nr.111-33902 /16

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin për zbatimin e të gjitha aktiviteteve për informim dhe monitorim të mediave; 20%
2. Menaxhon dhe monitoron në vazhdimësi ndërlidhjen e Komunës me mediat e shkruara dhe elektronike si dhe gazetaret me të cilët punohet në baza të rregullta dhe përgatit përmbledhje të informatave për menaxhmentin e lartë të Komunës; 15%
3. Përcjellë shkrimet dhe publikimet e mediave lidhur me aktivitete dhe shërbimet e Komunës dhe përgatit përgjigjet, reagimet sipas nevojës; 10%
4. Mban dhe përditëson një bazë të dhënash të kontakteve të mediave dhe krijon marrëdhënie të mira me gazetaret kryesorë, 10%
5. Ndihmon mbikëqyrësin dhe në bashkëpunim me të bënë përgatitjen e kumtesave, informatave, raporteve dhe publikimeve tjera për publikun; 15%
6. Pranon kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, evidenton kërkesat dhe i përcjell tek burimet përkatëse të cilët duhet të përgjigjet; 10%
7. Kujdeset për mirëmbajtjen dhe futjen e të dhënave në ueb-faqen zyrtare të komunës. Mirëmban, ruan dhe arkivon të gjitha kumtesat, informatat, raportet dhe publikimet tjera për publikun të Komunës si dhe shkrimet e mediave të shkruara dhe elektronike për Komunën; 15%
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloretë cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Diplomë universitare; Fakulteti i gazetarisë ose në ndonjë fushë të përafërt,
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : pa afat të caktuar

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 03.11.2016 deri më 17.11.2016.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -**Zyra e pranimit**, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”. “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

